

**AKT THEMELIMI I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“FIT ZONE” SHPK**

Sot, më datë 16/03/2021, ortakët si më poshtë:

1. **Z. Ardian Balaj**, shtetas Kosovar, lindur më 28.11.1980 lindur ne Prishtine, dhe banues në Prishtine, identifikuar me pasaportën me nr.K00878217, dhe nr.personal 1005946936, email: ardian.balaj12@icloud.com me numër telefoni 044555455;
2. **Z.Romeo Karabeci**, shtetas shqiptar, lindur më 02.07.1990 në Tirane dhe banues në Tiranë identifikuar me Pasaporten me Nr.BB8000079, Nr.personal J00702062G, email: karabeciromeo@gmail.com me numër telefoni 0692712421;
3. **Z.Klajdi Gjumsi**, shtetas shqiptar, lindur më 09.09.1997 në Tirane dhe banues në rrugën “Valentina Pistoli” Tiranë identifikuar me Kartën e Identitetit me Nr. Karte 033616309, Nr. personal J70909045S, email: klajdi.gjumsi@hotmail.com me numër telefoni 0685559865;

Vendosën të hartojnë këtë Akt Themelimi, me përmbajtje si më poshtë:

**NENI 1
DATA E THEMELIT**

Sot, më datë 16.03.2021, themeluesit vendosën të krijojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “FIT ZONE” SHPK.

**NENI 2
FORMA E SHOQËRISË**

Kjo shoqëri do të jetë me përgjegjësi të kufizuar (SHPK) derisa të vendoset ndryshe për shndërrimin në një formë tjetër ligjore të parashikuar nga legjislacioni për shoqëritë tregtare.



**NENI 3
EMËRTIMI**

Emri i plotë i shoqërisë është **“FIT ZONE” SHPK**.

**NENI 4
SELIA**

6.1 Selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë, në adresën: Bulevardi “Bajram Curri”, përballë ish-ekspozitës “Shqiperia Sot”.

Me miratim të organeve të saj, shoqëria mund të ndryshojë selinë, mund të hapë degë, filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë apo jashtë saj.

**NENI 5
KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

Shoqëria fiton personalitetin juridik në datën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe nga kjo datë ajo mund të fillojë të ushtrojë aktivitetin tregtar deri kur me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të vendoset prishja e shoqërisë, ose kur shoqëria mbaron në një nga mënyrat e parashikuara në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

**NENI 6
OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

Shoqëria **“FIT ZONE” SHPK** do të ketë si objekt të veprimtarisë:

Importe dhe shitje me pakicë dhe të shumicë të produkteve ushqimore të ndryshme, suplemente, ushqime proteinike etj .

**NENI 7
KAPITALI**

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 100.00 (njëqind) Lekë, i zotëruar plotësisht nga ortakët si më poshtë:

Emri	Perqindja %	Kuota (pjesë)	Vlera e Pjesmarrjes
Ardian Balaj	33.33 %	1	33.33 (Lekë)
Romeo Karabeci	33.33 %	1	33.33 (Lekë)
Klajdi Gjumsi	33.34 %	1	33.34 (Lekë)

Ky kapital është i ndarë në (tre) kuota të zotëruara nga tre ortakët.
Kapitali themeltar do të depozitohet ne një Bankë në Shqipëri, me një llogari të hapur në emër të shoqërisë në formim e sipër.

NENI 8 ADMINISTRATORI

Administratori i parë i shoqërisë "FIT ZONE" SHPK do të jetë:

Z. Romeo Karabeci, shtetas shqiptar, lindur më 02.07.1990 në Tirane dhe banues në Njesia Bashkiake nr.11, Rr Koli Bano 056 1, Tiranë, identifikuar me Pasaporten me Nr. BB8000079, Nr.personal J00702062G, email: karabeciromeo@gmail.com me numër telefoni 0692712421

Kohëzgjatja e mandatit të tij është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

NENI 9 DISPOZITA E FUNDIT

Ky akt themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje, në gjuhën shqipe, me fuqi të njëjtë ligjore.
Të dhënat tregtare të detyrueshme si dhe të dhënat e tjera për shoqërinë e sapokrijuar, gjenden të detajuara në Statutin e shoqërisë bashkangjitur.

Autorizohet Administratori **Z.Romeo Karabeci** për të kryer veprimet e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

THEMELUESIT

Ardian Balaj

Ardian Balaj
AB

Romeo Karabeci

Romeo Karabeci
RK

Klajdi Gjumsi

Klajdi Gjumsi
KG